

VENDIM
Nr.248, datë 27.4.2007

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si institucion juridik publik, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.
2. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka objekt të veprimtarisë:
 - a) Hartimin dhe zbatimin e politikave, të strategjive, akteve, ligjore dhe nënligjore, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (SHI);
 - c) Bashkërendimin e politikave dhe të programeve në fushën e SHI-së;
 - ç) Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;
 - d) Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;
 - dh) Edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-së nga publiku.
3. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:
 - a) Harton strategjinë kombëtare për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj;
 - b) Përgatit bazën ligjore për zhvillimin e SHI-së;
 - c) Bashkërendon reformat, programet dhe projektet në fushën e SHI-së, që zbatohen në të gjitha institucionet publike;
 - ç) Përcakton standardet e TIK-së për administratën publike;
 - d) Zhvillon një rrjet të brendshëm të TIK-së për administratën publike, përfshi krijimin e rrjetit qeveritar (*GovNet*) dhe të portalit qeveritar;
 - dh) Bashkërendon projektet për kompjuterizimin e të gjithë sektorëve të administratës publike, duke i dhënë përparësi kompjuterizimit të institucioneve, që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për publikun dhe bizneset;
 - e) Drejton strategjinë dhe projektet për ngritjen e shërbimeve *on line* të administratës publike, përfshi të gjitha shërbimet e qeverisjes elektronike;
 - ë) Mbështet dhe bashkërendon projektet për dixhitalizimin e bazës ligjore, të dokumentacionit, arkivave, bibliotekave, etj;
 - f) Nxit dhe mbështet përdorimin e internetit dhe TIK-së në shkolla, përfshi kompjuterizimin dhe aksesin në internet të të gjitha shkollave publike;
 - g) Nxit dhe mbështet zhvillimin e biznesit *on line* (ebusiness);
 - gj) Propozon politika, nxitëse dhe mbështetëse, për zhvillimin e infrastrukturës së TIK-së dhe të investimeve private në këtë fushë;
 - h) Promovon përhapjen e internetit dhe aksesin e publikut në shërbimet *on line*;
 - i) Promovon dhe mbështet rritjen e aftësive për përdorimin e kompjuterit dhe të internetit nga qytetarët;
 - k) Bashkëpunon në fushën e SHI-së me institucione të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.
4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.
5. Agjencia financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga projekte të ndryshme, nga institucione të huaja, si dhe nga burime të tjera, të ligjshme.
6. Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit.
7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj Agjencie rregullohen me Kodin e Punës.

Pranimi në punë bëhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

8. Efektet financiare, në shumën 33 282 368 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2007, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha